



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. ___ Prot

Maliq, më 22.02.2024

PROJEKT VENDIM
Nr. 3 datë 22/02 2024

“Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”

Në zbatim të shkresës nr.446/2, datë 20.02.2024 të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile “Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” është akorduar fondi prej **7,853,886.9 lekë** në formën e transfertës së kushtëzuar .

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” gërma (dh) , Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar me nr.290, datë 17.5.2023 , ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” , Udhëzimit të Ministrisë të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024” i kërkoj Këshillit të Bashkisë

1. Të miratojë detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile në vlerën **7,853,886.9 lekë** si më :

Tabela për shpenzimet e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile			
Nr.	Zërat e shpenzimeve	Shuma	%
a	Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme ndërtimore në mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve”- Kodi 917007AG	4,853,886.9	61.8
b	Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme – Kodi 91707AB	3,000,000	38.2
	Totali	7,853,886.9	

2. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Sektori i Emergjencave Civile në bashki.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

RELACION

“Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”

Fondi i Emergjencave Civile që ja u kemi sjellë për detajim propozohet nga ana jonë për zbatim në 2(dy) zëra .

1. Shpenzime për përballimin e dëmeve nga zjarri dhe fatkeqësi të tjera natyrore e përcaktuar në zërin “Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme” – Kodi 91707AB

-Kjo vlerë është vendosur duke patur parasysh faktin e një viti më parë dhe shpenzime të pa mbuluara nga viti 2024 të cilat do të përdoret rast pas rasti me Vendim të Këshillit të Bashkisë ;

2. Rehabilitim i objekteve infrastrukturore e përcaktuar në “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme ndërtimore në mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve”- Kodi 917007AG

– Nga evidentimi i situatës në territor është vërejtur se disa godina janë në rrezik të madh për jetën e banorëve dhe kërkohet një ndërhyrje e shpejtë për të eliminuar shkatërrimin e mëtejshëm. Kemi të bëjmë me banesa kolektive për të cilat nuk del përgjegjësia për situatën e krijuar dhe ku një numur familjesh në katet e sipërme janë larguar prej vitesh jashtë shtetit.

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

